



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ

Shqyrtimi i Tretë Periodik për Periudhën Rregullatore 2023 – 2027

Faktori i efijencës

DEKLARATA

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të informuar palët e interesuara në sektorin e energjisë. Raporti nuk paraqet vendimmarrje të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

13 shtator 2022



Tabela e Përmbajtjes

1	Prezantimi	3
2	Përmbledhje e propozimeve dhe komenteve nga Ndërmarrjet e Rregulluara për Faktorin e Efiçencës për Periudhën Rregulative 2023 – 2027	4
3	Faktori i Efiçencës OPEX (X)	6
4	Propozimi i ZRRE-së për Faktorin e Efikasitetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS).....	7
4.1	Efkti i Efiçencës Catch-up	7
4.2	Komponenti i zhvendosjes së kufirit të efiçencës.....	8
4.3	Praktikat e Rregullatorit Evropian.....	11
4.4	Propozimi i ZRRE-së për Faktorin e Efiçencës	12



1 Hyrje

Bazuar në mandatin e dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe rregullat e miratuara për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (OST/OT-KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS), ZRRE-ja ka filluar procesin e Rishikimit të Tretë të Tarifave Shumëvjeçare (Periodha Rregullative – “PRR 3”) për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara të të licencuarve të KOSTT-it dhe KEDS-it për periudhën e ardhshme 5-vjeçare 2023-2027 (1 prill 2023 - 31 mars 2028).

Më 26 maj 2022, ZRRE-ja u ka dërguar të licencuarve (KOSTT dhe KEDS), si dhe kopje Kuvendit dhe Ministrisë së Ekonomisë "Letrën e Inicimit" për t'i informuar ata rreth Planit të ZRRE-së lidhur me Rishikimin e Tretë Periodik për periudhën rregullative 2023 - 2027.

Për të përcaktuar të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për OST/OT (KOSTT) dhe OSSH (KEDS), ZRRE-ja do të përcaktojë paraprakisht variablat kryesore të parametrave hyrës (inputeve) rregullative në mënyrë që të sigurojë kohë dhe informacion të mjaftueshëm për palët në procesin e konsultimit publik. Kjo praktikë është përdorur edhe në dy rishikimet e mëparshme të tarifave. Vlerat e parametrave rregullativ që do të vendosen pas diskutimit publik janë:

- Niveli fillestar dhe shkalla e pritur e reduktimeve të humbjeve në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes.
- Shkalla e pritur e përmirësimeve të efijencës në kostot operative të OST-së dhe OSSH-së, e cila është objekt i këtij raporti konsultativ.
- mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (WACC) e OST-së dhe OSSH-së.
- Jetëgjatësia e përshtatshme e asetëve që do të përdoret për qëllime të llogaritjes së amortizimit rregullativ të investimeve të reja.
- Faktori i ndarjes së humbjeve.
- Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet që tejkalojnë faktorin e efijencës dhe
- Çdo parametër tjetër hyrës që rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.

Ky raport konsultativ do të fokusohet në faktorin e efijencës për OST/OT dhe OSSH për periudhën 2023 - 2027 dhe shërben për konsultim publik.

Çdo koment për këtë raport konsultativ duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike me email në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org ose të dorëzohet në kopje fizike në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit të Energjisë - Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve

Rruga: Bekim Fehmiu (Ish- ndërtesa Fazita), kati: 2, Prishtinë, 1000, Kosovë



Çdo koment nga palët e interesuara duhet të dorëzohet jo më vonë se 28 shtator 2022.

ZRRE-ja rezervon të drejtën të publikojë çdo koment të marrë tërësisht ose pjesërisht, përveç nëse ai identifikohet si konfidencial.

2 Përmbledhje e propozimeve dhe komenteve nga Ndërmarrjet e Rregulluara për Faktorin e Eficiencës për Periudhën Rregullative 2023 – 2027

Bazuar në dokumentin inicues të dërguar nga ZRRE-ja për hapjen e procesit të Rishikimit të Tretë Periodik për Tarifat Shumëvjeçare (PRR 3), Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT), ka përgatitur dhe dorëzuar në ZRRE propozimin e tyre për Faktorin e Eficiencës për Periudhën Rregullative 2023 – 2027.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) nuk ka dorëzuar propozimin e tyre për Faktorin e Eficiencës për Periudhën Rregullative 2023 – 2027.

KOSTT-i propozon që vlera e Faktorit të Eficiencës të vendoset në 0 (zero) për Rishikimin e ardhshëm Periodik (PRR 3). KOSTT-i ka ofruar arsyet e mëposhtme për të arsyetuar propozimin e tyre:

1. Niveli i Faktorit të Eficiencës u vendos në mënyrë arbitrare në 1.5% duke përdorur një metodologji të krijuar kryesisht për vendet shumë të zhvilluara.
2. Faktori i Eficiencës nuk përdoret në mënyrë domethënëse në Shtetet Anëtare të ERRA (Asociacioni Rajonal i Rregullatorit të Energjisë) dhe një vlerë prej 1.5% nuk është tipike për vendet anëtare.
3. Si kompani shtetërore, KOSTT nuk ka fleksibilitet të mjaftueshëm për të menaxhuar kostot, si numri dhe paga e punëtorëve, negocimi i çmimeve me furnitorët etj.
4. Gjatë periudhës së mëparshme rregullative, ka një korrelacion minimal midis OPEX-it të lejuar dhe OPEX-it aktual.
5. Baza e aseteve të KOSTT-it është rritur gjatë viteve për të përmbushur nevojat e Kosovës për energji elektrike.
6. Ka projekte të reja kapitale të planifikuara për 5 vitet e ardhshme të cilat do të rrisin kostot O&M. (operative dhe mirëmbajtjes)
7. Rregulloret e reja për pajtueshmërinë me rregulloret qeveritare, standardet mjedisore dhe standardet e shëndetit dhe sigurisë rrisin kostot.
8. Raporti i fundit i ENTSO-E kërkon nga KOSTT-i që të rrisë stafin dhe të rrisë kostot operative, duke marrë parasysh detyrat dhe kërkesat e reja që dalin nga ENTSO-E.



9. Limitet në rrjedhën e parasë në të kaluarën kanë pasur ndikim në KOSTT, duke rezultuar në anulimin ose shtyrjen e projekteve O&M. Kriza e mëtejshme e energjisë elektrike do ta përkeqësojë situatën në KOSTT.



3 Faktori i Eficiencës OPEX (X)


Faktorët e eficiencës përdoren nga rregullatorët në mbarë botën për të nxitur konkurrencën e tregut në tregjet monopolistike. Ato kufizojnë çmimet e paarsyeshme dhe vendosin stimuj që shoqëritë të funksionojnë në mënyrë efikase.

Në fillim të Periudhës Rregullative ZRRE vendos nivelin bazë OPEX, i cili është i njëjtë me OPEX-in e lejuar për vitin e fundit të Periudhës së mëparshme Rregullative. Baza e lejuar OPEX për periudhën rregullative vijuese përshtatet duke marrë parasysh përgjegjësitë e reja ose heqjen e përgjegjësisve nga shërbimi publik. Kështu, pikat 5 – 9 të dokumentit konsultativ të KOSTT-it do të adresohen gjatë vendosjes së bazës së lejuar OPEX.

Niveli bazë i lejuar OPEX për periudhën e re rregullative përshtatet më pas çdo vit me Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë për Eurozonën dhe për Faktorin e Eficiencës sipas rregullave. ZRRE-ja kufizon efektin e Faktorit të Eficiencës në OPEX të kontrollueshëm.

ZRRE nuk vendos OPEX-in e lejuar ose faktorin e efikasitetit për çdo linjë të OPEX-it, në mënyrë që të mundësojë fleksibilitet të të licencuarit në vlerësimin e mënyrës më efikase të arritjes së cilësisë së furnizimit.

Figura 1: Aplikimi i ZRRE-së i faktorit të efikasitetit në bazën OPEX.



ZRRE vendos Faktorin e Eficiencës bazuar në përfitimet e pritshme të efikasitetit të OPEX të operatorëve për periudhën rregullative.

Siç u përmend, kur të merret parasysh OPEX-i shtesë i lejuar për Rishikimin e Tretë të Tarifave Shumëvjeçare (PRR3), ZRRE-ja do të analizojë dhe shqyrtojë rishikimin e ri.




4 Propozimi i ZRRE-së për Faktorin e Efikasitetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS)

Në një treg konkurrues që funksionon mirë, shoqëritë synojnë të rrisin efikasitetin e tyre për të fituar një avantazh ekonomik ndaj konkurrentëve të tyre. Ekzistojnë dy elementë kryesorë të përmirësimit të efikasitetit të njohur në literaturë:

- **Efekt i arritjes (catch-up)**, i cili përfshin të gjitha përmirësimet brenda ndërmarrjes për të arritur praktikat më të njohura në një industri, ose me fjalë të tjera, arritjen e performuesit më të mirë në treg.
- **Efekt i zhvendosjes së kufirit (efikasiteti frontier)**, i cili lidhet me ndryshimet e praktikave më të mira në industri, përmes avancimeve teknologjike dhe praktikave të reja të punës.

Dy komponentët e lartpërmendur janë paraqitur vizualisht në Figura 2.

Figura 2. Përfaqësimi vizual i efektit Catch-up dhe i zhvendosjes së kufirit



4.1 Efekt i Eficiencës Catch-up

Përcaktimi i shkallës së efikasitetit të arritjes së një kompanie është subjekt i përcaktimit të kompanisë më efikase ose kufirit të efikasitetit. Kjo mund të bëhet në 2 mënyra kryesore:

- **Krahasimi i kompanive që operojnë në treg të ngjashëm** – Kjo metodologji ka përdorim të kufizuar në kontekstin e Kosovës, duke pasur parasysh se KEDS dhe KOSTT janë OSSH dhe OST e vetme, respektivisht. Kryerja e një analize krahasuese do të kërkonte qasje në të dhënat e



detajuaru financiare të OST-ve dhe OSSH-ve rajonale të krahasueshme, në të cilat është e vështirë të fitohet qasje.

- **Përcaktimi i kufirit të efikasitetit duke përdorur një rrjet virtual referimi**– Ndërsa kjo metodologji përdoret për të përcaktuar kufirin e efijencës në tregjet me pjesëmarrës të kufizuar, është proces kompleks dhe i gjatë. Për më tepër, kërkon të dhëna cilësore mbi topologjinë e rrjetit, kostot për njësi, parashikimet e kërkesës për të ardhmen etj. Për më tepër, rezultatet varen shumë nga zgjedhja e specifikimeve hyrëse dhe dalëse (input dhe output).

Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe mungesën e të dhënave për të realizuar metodologjitë e lartpërmendura, ZRRE-ja nuk do të vendos një faktor të efijencës për KOSTT-in ose KEDS-in dhe supozon se si KOSTT-i ashtu edhe KEDS-i operojnë në nivelin aktual më efikas.

4.2 Komponenti i zhvendosjes së kufirit të efijencës

Përcaktimi i faktorit të efijencës për KOSTT-in dhe KEDS-in do të bazohet në lëvizjen e kufirit, duke pasur parasysh se edhe nëse KOSTT dhe KEDS funksionojnë në mënyrën më efikase, përmirësimet e efijencës në të ardhmen mund të arrihen përmes teknologjive dhe praktikave të reja të punës.

Ekzistojnë dy metoda kryesore për të përcaktuar potencialin e ardhshëm të lëvizjes së kufirit në kompanitë e energjisë elektrike:

- **Krahasimet indirekte** – janë bazuar në të dhënat nga kompanitë ose sektorët e rregulluar të krahasueshëm në të kaluarën. Supozimi është se është e mundur të vlerësohet shkalla historike e zhvendosjes së kufirit të sektorëve të krahasueshëm dhe të supozohet se niveli i kaluar i zhvendosjes së kufirit është një tregues i mirë i zhvendosjes së mundshme të kufirit në të ardhmen. Për më tepër, ai supozon se zhvendosja e vendosur në të ardhmen e kufijve të sektorëve të krahasueshëm është një tregues i mirë i shkallës së progresit të përgjithshëm teknologjik dhe mund të bartet edhe në sektorin e energjisë elektrike.

Disa rregullatorë në Evropë përdorin këtë metodologji për të vendosur normën e zhvendosjes së kufirit. Megjithatë, kjo metodologji kërkon të dhëna për indikatorët e rritjes, si p.sh. Produktiviteti i Faktorit Total (TFP) nga disa industri të krahasueshme. Për Evropën, këto të dhëna janë të disponueshme në databazën KLEMS. Kjo metodologji është objekt i diskutimeve se cilët sektorë duhet të konsiderohen si të krahasueshëm dhe në çfarë mase. Për më tepër, pasi që metodologjia supozon se performanca e kaluar e sektorëve të tjerë është një tregues i performancës të ndërmarrjeve të energjisë elektrike në të ardhmen, gjë që shpesh nuk ndodh.

ZRRE-ja konsideron se treguesit e rritjes së industrisë nuk janë përfaqësim valid i treguesve të rritjes për kompanitë e energjisë elektrike në Kosovë. Për më tepër, në mungesë të të dhënave të tilla për sektorët e krahasueshëm në Kosovë dhe zbrazëtirave që i ka kjo metodologji, ZRRE-ja zgjedh të mos e bëjë këtë krahasim.



- **Krahasimet e drejtpërdrejta** – përdorimi i të dhënave të kompanisë me kalimin e kohës për të vlerësuar shkallën historike të zhvendosjes së kufirit të arritur nga kompania. Kjo supozon se shkalla e progresit në të kaluarën është një tregues i mirë i progresit të mundshëm në të ardhmen. Kjo metodologji kërkon të dhëna vetëm për të licencuarin specifik (në këtë rast KOSTT-in dhe KEDS-in). Mangësitë e kësaj metodologjie janë se ato nuk marrin parasysh efektet e mundshme të mjedisit të cilat mund të kenë çuar në rritje ose ulje të efijencës në të kaluarën. Për më tepër, përfitimet e Efijencës në të kaluarën nuk garantojnë përfitime të Efijencës në të ardhmen me të njëjtën normë, ose fare.

Efijencia përgjithësisht konsiderohet si raporti ndërmjet daljeve dhe hyrjeve (output dhe input) (me përshtatjen e mjedisit). Por marrë parasysh mangësitë e mësipërme, ZRRE-ja ka realizuar një analizë për të përcaktuar nëse janë arritur përfitimet e efijencës në periudhën e kaluar rregullative për ndërmarrjet specifike (KEDS-in dhe KOSTT-in), kjo është bërë duke u bazuar në të dhënat financiare të KOSTT-it dhe KEDS-it duke aplikuar metodologjinë e Krahasimit Direkt për të dy operatorët.

Për analizë ZRRE-ja përdori të dhënat financiare aktuale të kontrollueshme të OPEX për periudhën e kaluar rregullative (2017 – 2022) dhe i përshtati ato duke konsideruar si vlerë bazike kostot e vitit 2017, duke marrë parasysh Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (HICP) në Evropë të raportuar nga Eurostat dhe të marra parasysh nga rregullatori gjatë përshtatjes vjetore. Kjo analizë mundëson vlerësimin e efijencës tek operatorët e rrjeteve në ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike, për shkak se disa nga aspektet volumetrike nuk kanë korelacion me Opex-in për shkak të ekonomizimit të shkallës.

Me qëllim të kalkulimit të efijencës së arritur gjatë PRR 2, ZRRE ka krahasuar Opex-in e realizuar në baza vjetore me Opex-in e shndërruar në vlera nominale për secilin vit, duke përdorur si vit bazë Opex-in e vitit 2017. Kjo mundëson që Opex-i të jetë i krahasueshëm fillimisht dhe më pastaj mundëson kalkulimin e efijencës së arritur nga OST/OT dhe OSSH në periudhën 2017-2021.

Të dhënat e përdorura janë paraqitur në tabelën e mëposhtme për të dy operatorët (KOSTT dhe KEDS).

			2017	2018	2019	2020	2021
OPEX aktuale e kontrollueshme	KOSTT	€m	6,942	6,670	7,176	7,466	7,963
	KEDS	€m	26,752	26,434	27,560	27,046	27,713
Viti baze 2017							
HICP		%		1.73	1.19	1.26	5.0
OPEX i kontrollueshëm i rregulluar për HICP	KOSTT	€m	6,942	7,062	7,146	7,165	7,523
	KEDS	€m	26,752	27,215	27,539	27,610	28,991

Rezultatet e faktorit të efijencës nga viti në vit dhe në mesatare për periudhën 2017-2021 të bazuar në tabelën e mësipërme janë paraqitur edhe në figurën 3 dhe 4. OSSH (KEDS) ka treguar efijencë në Opex nëpër vite, dhe efijencia mesatare e arritur për periudhën 2017-2021 është 2.34%, ndërsa OST/OT (KOSTT) nuk ka arritur të jetë efijent, duke rritur kështu Opex-in mesatar në 1.31% gjatë kësaj periudhe.



Figura 3. Efienca e OST/OT 2017-2021





Figura 4. Efienca e OSSh 2017-2021





4.3 Praktikave të Rregullatorit Evropian

ZRRE iu referua të dhënave dhe praktikave rregullative të përdorura në vende të tjera për të propozuar një faktor të efijencës. Përderisa ka zbatim të kufizuar të faktorëve të efijencës të përdorur në vende të ndryshme, vlerat e ofruara shërbejnë si bazë e mirë për shqyrtimin e ZRRE-së. Asociacioni Rajonal i Rregullatorit të Energjisë (ERRA) inkurajon rregullatorët e vendeve anëtare të përcaktojnë faktorët e efijencës, duke marrë parasysh statusin e monopolit dhe konkurrencën e kufizuar të tregut për OST-të dhe OSSH-të.

Vlera e Faktorëve të Efijencës të përdorur nga rregullatorë të ndryshëm për OSSH dhe OST është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	OST	OSSH	Referenca
Austria	Varet nga kompania	1.25% - 4.4%	Baza e të dhënave ERRA
Butani	2.0%	2.0%	Baza e të dhënave ERRA
Republika Çeke	1.0%	1.0%	Baza e të dhënave ERRA
Finlanda	2.2%	2.2%	WIK-Consult, krahasimi i kostos në rregullimin e energjisë në vendet evropiane.
Gjeorgjia	1.5%	1.5%	Baza e të dhënave ERRA
Hungaria	1.5%	1.5%	Baza e të dhënave ERRA
Lituania	1.0%	1.0%	Baza e të dhënave ERRA
Moldavia	1.0%	1.0%	Baza e të dhënave ERRA
Holanda	1.5%	1.5%	WIK-Consult, krahasimi i kostos në rregullimin e energjisë në vendet evropiane.
Nigeria	4%		Studimi i ERRA mbi Qasjet Rregullative të Përcaktimit të të Hyrave, 2017
Irlanada veriore	0,80%	0,80%	Rregullatori i shërbimeve, Efektet reale të çmimeve dhe produktiviteti RP6, Përcaktimi përfundimtar, 2017
Norvegjia	1.5%	1.5%	WIK-Consult, krahasimi i kostos në rregullimin e energjisë në vendet evropiane.
Omani	1%	1%	Studimi i ERRA mbi Qasjet Rregullative të Përcaktimit të të Hyrave, 2017
Polonia	1.50%	1.50%	Studimi i ERRA mbi Qasjet Rregullative të Përcaktimit të të Hyrave, 2017
Rumania	1 - 1,5%	2%	Baza e të dhënave ERRA
Slovakia	3.5%	3.5%	Baza e të dhënave ERRA
Turqia		1.17%	Baza e të dhënave ERRA
MB	1.25%	1.25%	OFGEM - RIIO-2 Përcaktimi Përfundimtar, 2020

Faktori mesatar i Efijencës i përdorur në grupin e të dhënave për OST-të është 1.7% me një interval prej 0.8% - 4%. Ndërsa, për OSSH-në mesatarja është 1.6%, me një interval 0.8% - 3.5%.



Studimi i ERRA mbi Qasjet Rregullative për Përcaktimin e të Hyrave (2017), sugjeroi që një faktor i efijencës i OPEX, për kompanitë e transmetimit që operojnë afër kufirit, prej 2% në vit është i arritshëm. Ndërsa për kompanitë e shpërndarjes një normë vjetore prej 1.5% - 2% e përfitimeve të Efijencës është e zakonshme.

4.4 Propozimi i ZRRE-së për Faktorin e Efijencës

ZRRE-ja e sheh Faktorin e Efijencës si vendimtar për ofrimin e stimujve për të licencuarit për të rritur efijencën, brenda një tregu me konkurrencë të kufizuar (inekzistente). Të licencuarit duhet të synojnë të rrisin efijencën kudo që të jetë e mundur, duke e rritur cilësinë e shërbimit dhe duke ofruar energjinë elektrike për konsumatorët me çmime të përballueshme.

ZRRE-ja e kupton se mungesa e të dhënave për të bërë një analizë të kufijve pengon aftësinë për të vendosur Faktorë Ambicioz të Efijencës, veçanërisht për komponentin e Faktorit të Efijencës.

ZRRE-ja konsideron se edhe nëse të licencuarit (KOSTT dhe KEDS) operojnë në nivele kufitare ose afër kufirit, përfitimet e efijencës ende mund të bëhen duke marrë parasysh zhvendosjen e kufirit, duke zbatuar teknologji të reja dhe praktika inovative të menaxhimit. Kjo është demonstruar gjatë periudhës së kaluar rregullative, ku si KOSTT-i ashtu edhe KEDS-i kanë treguar potencialin për të arritur përfitimet e efijencës të OPEX-it. ZRRE-ja do të shqyrtojë përgjegjësi të reja për KOSTT-in dhe KEDS-in kur të vendos nivelin bazë të OPEX-it.

Duke marrë parasysh: a) efijencën e arritur nga OSSH si arritje e performuesit më të mirë, ZRRE sipas qasjes “catch-up”; b) si dhe Studimin e ERRA për faktorin mesatar të efijencës së përdorur për OST dhe OSSH:

ZRRE propozon një Faktor të Efijencës OPEX prej 1.5% - 2% në vit për KEDS (OSSH) dhe KOSTT (OST) gjatë PRR3.

ZRRE propozon nivel të njejtë të efikasiteti edhe për OST/OT duke pritur që kjo ndërmarrje do të arrijë efikasitetin e ndërmarrjeve me performancën më të mirë. ZRRE-ja beson se ky brez është i arritshëm, duke marrë parasysh aplikimin e saj nga rregullatorët tjerë dhe performancën të operatorëve në të kaluarën (KOSTT dhe KEDS).

Bazuar në Praktikën e mëparshme Rregullative, ZRRE-ja propozon që faktori i ndarjes së kursimeve për kursimet që tejkalojnë faktorin e efijencës për kostot operative do të ndahet ndërmjet të licencuarit dhe konsumatorëve sipas faktorit 50/50. Në rast të shpenzimeve që tejkalojnë nivelin e lejuar, ato do të mbulohen nga të licencuarit në përputhje me Rregullat për të Hyrat.